

I/e nderuar Prind/Kujdestar/e:

Fëmija juaj ka qenë duke marrë shërbime shëndetësore dhe/ose akomodime të arsyeshme në shkollë dhe në programet/aktivitetet e sponsorizuara nga DOE, në bazë të seksionit 504 të ligjit "Për rehabilitimin" të vitit 1973. Këto shërbime ndihmojnë një nxënës me nevoja shëndetësore të marrë pjesë në shkollë në mënyrë të barabartë me bashkëmoshatarët e tij që nuk kanë aftësi të kufizuara. Për shembull, nxënësit me një gjendje mjekësore mund të marrin medikamente në shkollë sipas udhëzimeve të ofruesit të tyre të kujdesit shëndetësor, ose nxënësit që kanë vështirësi në shikim apo dëgjim mund të ulen afër tabelës së zezë.

Zyra e Shëndetit të Shkollës (Office of School Health) shqyrton çdo vit kërkesat për akomodime mjekësore për të konfirmuar nëse fëmija juaj ka ende nevojë për shërbime dhe/ose akomodime në shkollë, dhe për të njoftuar shkollën për çdo ndryshim në mënyrë që nevojat e fëmijës suaj të plotësohen.

Për t'u përgatitur për vitin e ardhshëm shkollor, ju lutemi:

- Kërkojini ofruesit të kujdesit shëndetësor të fëmijës tuaj të plotësojë [Formularin e Administrimit të Medikamenteve për Diabetin, Formularin\(et\) e Administrimit të Medikamenteve dhe/ose Formularin për Trajtim të Përshkruar Mjekësisht](#) (Ngjitni një fotografi të vogël dhe të kohëve të fundit në cepin lart majtas).
  - Pasi të keni shqyrtuar formularët e plotësuar nga ofruesi i kujdesit shëndetësor të fëmijës tuaj, nënshkruani faqen e pasme të formularit(ve) dhe përfshini informacionin tuaj të kontaktit. Ju duhet të nënshkruani formularët në mënyrë që fëmija juaj të fillojë të marrë medikamente/trajtim mjekësor nga infermierja e shkollës.
- Dorëzoni Formularin e Administrimit të Medikamenteve për Diabetin (Diabetes Medication Administration Form), ose Formularin(et) e Administrimit të Medikamenteve (Medication Administration Form), dhe/ose Formularin për Trajtim të Përshkruar Mjekësisht (Medically Prescribed Treatment Form) te infermierja e shkollës sa më herët që më **1 qershor 2025, ose sa më shpejt të jetë e mundur**, në mënyrë që fëmija juaj të marrë shërbimet e autorizuara që në fillim të vitit shkollor 2025-2026.
- Për të kërkuar akomodime të reja ose të modifikuara mjekësore në Planin 504 të fëmijës suaj: dorëzoni [Formularin e kërkesës për akomodime mjekësore me shtojcë](#) (të plotësuar nga ofruesi i kujdesit shëndetësor të fëmijës suaj, te Koordinatori 504 i shkollës, së bashku me) [Formularin e prindit për kërkesë për shërbime shëndetësore/akomodime sipas seksionit 504 me autorizim sipas HIPAA-s sa më shpejt të jetë e mundur para përfundimit të vitit shkollor](#) për të siguruar që akomodimet të jenë të gatshme që në ditën e parë të vitit të ardhshëm shkollor.

Formularët për Administrimin e Barnave për Diabetin, Formularët për Administrimin e Barnave, dhe/ose Formularët për Trajtime të Përshkruara Mjekësisht që dërgohen pas përfundimit të vitit shkollor mund të dorëzohen në mënyrat si më poshtë:

	<b>Email (në varësi të lagjes ku do të ndjekë shkollën fëmija juaj)</b>	<b>Postë</b>	<b>Faks.</b>
<b>Formularët për Administrimin e llaçeve për Diabetin</b>	<a href="mailto:OshDMAF@health.nyc.gov">OshDMAF@health.nyc.gov</a>	Drejtuar: Koordinator i DMAF Departamenti i Shëndetit dhe Higjienës Mendore i Qytetit të Nju Jorkut (New York City DOHMH) Zyra e Shëndetit të Shkollës (Office of School Health) 42-09 28th Street, CN-25 Queens, New York 11101-4714	Bronx & Manhattan: 347-396-8945 Brooklyn & Staten Island: 347-396-8933 Queens: 347-396-8932
<b>Të gjithë Formularët e tjerë për Administrimin e Barnave dhe Formularët për Trajtime të Përshkruara Mjekësisht</b>	<a href="mailto:BronxMAF@health.nyc.gov">BronxMAF@health.nyc.gov</a> <a href="mailto:BrooklynMAF@health.nyc.gov">BrooklynMAF@health.nyc.gov</a> <a href="mailto:ManhattanMAF@health.nyc.gov">ManhattanMAF@health.nyc.gov</a> <a href="mailto:QueensMAF@health.nyc.gov">QueensMAF@health.nyc.gov</a> <a href="mailto:StatenIslandMAF@health.nyc.gov">StatenIslandMAF@health.nyc.gov</a>	Drejtuar: Drejtori i Infermierisë Departamenti i Shëndetit dhe Higjienës Mendore i Qytetit të Nju Jorkut (New York City DOHMH) Zyra e Shëndetit të Shkollës (Office of School Health) 42-09 28th Street, CN-25 Queens, New York 11101-4714	